



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I. Numër: 060/01-12402, datë: 26 Shkurt 2026

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë: 04 qershor 2008), nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi të datës 22.08.2012 dhe nenit 20 paragrafi 1.4 të Statutit nr.01/2020 të Komunës së Pejës, Numër: 01-016/01-413431/2020, datë: 30 shtator 2020, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 26 Shkurt 2026, merr këtë:

VENDIM

Nr. 03/2026

për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

- I. Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Pejës, në përbërje si vijon:
1. Gazmend Muhaxheri, Kryetari i Komunës – Kryesues,
 2. Faik Jahmurataj, Komandant i Stacionit të Policisë – anëtar,
 3. Fatmir Asllani, Nënkryetar i Komunës – koordinator i KKSB-së,
 4. Naser Gega, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – anëtar,
 5. _____, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, - anëtar,
 6. Vedat Shatri, toger i FSK-së – anëtar,
 7. Arta Kollqaku, Këshilli Prindor – anëtare,
 8. Samka Drançolli, Zyra Komunale për Barazi Gjinore – anëtare,
 9. Adelina Kovaçeviq, Zyra për Komunitete - anëtare,
 10. Musli Arifaj, Kryetar i BIP – anëtar,
 11. Pal Marku, Famullia Katolike – anëtar,
 12. Esat Kica, Bashkësia Ungjillore – anëtar,
 13. Dragan Radovanoviqa, Kisha Ortodokse – anëtar,
 14. Fadil Berisha, Teqja e Tarikatit Kaderi – anëtar,
 15. Nora Draga, KLSP, zona Qendër - Pejë – anëtare,
 16. _____, KLSP, Levosh – anëtar,
 17. Edina Honsiq, Komuniteti Boshnjak - anëtare,
 18. Miodrag Dashiq, Komuniteti Serb, Sigë/Brestovik – anëtar,
 19. Dushan Portiq, Komuniteti Serb, Gorozhdec – anëtar,
 20. Diana Sefaj, Komuniteti Egjiptian – anëtare,
 21. Evzi Haxhoviq, Komuniteti Rom – anëtar,
 22. Naser Lajqi, Shoqëria Civile – anëtar,
 23. Dardane Kastrati, Mediat – anëtare,
 24. Fitore Cena Haxhihasani, OJQ me nevoja specifike – anëtare,
 25. Benisere Bukleta, Komuniteti i Biznesit – anëtare,
 26. _____, Komuniteti për Komunitete – anëtare,
 27. _____, EVSB – anëtar.

- II. Detyrat, të drejtat dhe obligimet e KKSBB-së janë të përcaktuara konkretisht më Udhëzimin Administrativ nr.27/2012 MPB, 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi të datës: 22.08.2012.
- III. Kompensimi i punës së anëtarëve të KKSBB-së, do të bëhet nga Buxheti Komunal, sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, vetëm për 6 (gjashtë) takime brenda vitit.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës, me nr. prot: 060-01/8033, dt. 31 Janar 2022 Mbi Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB-së Pejë me vendime tjera pasuese mbi ndryshimin dhe plotësimin e tij.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet e Financa e Komunës së Pejës.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
Anëtarëve të Komitetit
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
Arkivë.

